

# NE VEPROJMË NË DOBI TË PAQES



## NE QYTETARËT NË DEMOKRACI

VALON (10), DIJON (10), ENSAR (10), GENC (10), MELISA (10), HEROLINDA (10), VJOSA (9)



### Qytetarët aktiv nuk mendojnë vetëm për vete. Ata bashkohen për të përmirësuar jetën në komunitet

Në demokraci, qytetarët dallojnë nga njëri-tjetri, jo në të drejta, jo në përgjegjësi, por vetëm në aktivizimin që kanë. Shteti ynë ka nevojë që të gjithë ne qytetarët e tij, të jemi aktiv në ndërtimin e demokracisë.

Po si mund ta bëjmë këtë gjë? Kjo është shumë e th-

dhe forcojmë shtetin tonë demokratik.

Meqë e përmendem shtetin demokratik, ne si qytetarë të këtij shteti kemi shumë të drejta. Këto të drejta i gëzojmë të gjithë pa dallime. Disa nga to janë: e drejta e votës, e drejta e shkollimit, e drejta e emrit, e drejta e të shprehurit lirshëm, etj.

Besojmë, po e shihni se e kemi vizatuar veturën e policisë. Policët kanë për detyrë të mbajnë rendin dhe ligjin. E edhe ne si qytetarë kemi përgjegjësi të respektojmë ligjin. Përgjegjësi tjetër e jona është edhe respektimi i njëri-tjetrit, ruajtja e ambientit, pagesa e taksave, ruajtja e pronave publike, etj.

Ne sot u kënaqëm shumë, por edhe mësuam shumë. Mësuam se të gjithë së bashku jemi si shtyllat e shtëpisë. Kjo shtëpi quhet demokraci. Për këtë arsye, le të jemi shtylla të forta dhe punëtore. Ta mbajmë demokracinë ashtu edhe si na ka hije. Faleminderit që ndatë kohën e juaj dhe e lexuat artikullin tonë.



Të drejtat tona na bëjnë të lumtur në demokraci. Këto të drejta i gëzojmë të gjithë pa dallime

jeshtë. E tëra që na duhet është përkushtimi dhe vullneti. Për shembull, ne në shkollën tonë mund të mbjellim fidane të ndryshme që të kemi ambient sa më të bukur dhe të pastër. Kjo nuk i shërben vetëm klasës sonë, por gjithë nxënësve të shkollës. Kjo nënkupton se çdo iniciativë e jona për të përmirësuar jetën në komunitet është aktivizim, për ndërtimin e demokracisë. Demokracinë e mbajmë ne në duar.

Andaj, t'i shfrytëzojmë duart tona, që ta ndërtojmë



Gazetarët e grupit „Yjet“



Përfaqësuesit e shtetit tonë, të cilët janë deputetët, zgjedhen nga populli




Në shtetin tonë, mbizotërojnë paqja, harmonia, respekti. Këto janë edhe elemente përbërëse të demokracisë



Padysim se duart tona janë të arta. Ato shkruajnë gjëra shumë të mira për sistemin më të mirë të qeverisjes, i cili është demokracia. Me duart tona ne e zhvillojmë edhe më tutje këtë sistem të vlerave




Ne si fëmijë që jemi kemi të drejta të shumta të cilat na mbrohen me ligj dhe me Kushtetutë



Jam shumë i lumtur, sepse unë trajtohem i barabartë me të gjithë të tjerët

## VOTA ËSHTË PËRGJEGJËSI E QYTETARËVE

VILDANE (10), ESMA (10), VENIS (10), LAVDRIM (10), DREN (10), ARBLINA (10), YLLKA (10), ALBIN (11)




**Secili qytetar ka të drejtë të vendos për jetën dhe të ardhmen e tij. Por, a e keni menduar ndonjëherë se nga vie liria jonë për të zgjedhur? Këtë do të mësoni këtu në artikullin tonë**

Ne jemi ende të vegjël dhe nuk e kemi të drejtën për të votuar deri në moshën 18 vjeçare. Si fëmijë që jemi, kemi të drejtën t'i shprehim lirshëm mendimet tona, kemi të drejtë të informohemi dhe të jemi aktiv në komunitetin tonë. Jemi shumë të rëndësishëm në ndërtimin e shtetit tonë demokratik që na ofron tërë këtë liri. Roli ynë do të fuqizohet edhe më shumë kur ne do të dalim dhe do të votojmë. Që nga kjo periudhë kohore në të cilën jemi, kemi mësuar se vota është përgjegjësi e qytetarit.

Prandaj, përgjegjësinë tonë duhet ta përmbushim kur të vijë koha e duhur e paraparë me ligj. Ne kemi pasur shumë raste kur vota e vetëm një personi ka bërë që një vendim të merr kahje tjetër. Kjo dëshmon se vetëm një votë ka fuqi shumë të madhe të bëjë ndryshim. P.sh. ne procesin e votimit e kemi përdorur edhe kur kemi pasur të zgjedhim kryetarin e grupit tonë.

Votimi na ka ndihmuar që të bëjmë zgjedhje të lehtë dhe demokratike. Kjo sepse të gjithë pjesëtarët e grupit tonë shprehëm mendimin tonë lirshëm dhe menduam paraprakisht se cili është nxënësi më i mirë për tu zgjedhur. Kështu ndodh edhe në zgjedhjet që mbahen në shtetin tonë. Ne i përkrahim shumë zgjedhjet e lira dhe demokratike, sepse kështu i jepet mundësi seci-



**Mosha e artë, për të bërë ndryshime të mëdha**


lit të jetë pjesë e vendimarrjes. Kosova si vend demokratik organizon dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore, ku zgjedhen deputetët si dhe zgjedhjet lokale, ku zgjedhen kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Qytetarë të dashur, besoj që rëndësinë e zgjedhjeve e keni kuptuar, prandaj mos harroni të dilni e të votoni.



**Të vendosur për ndryshime pozitive**

# INFORMATAT E SAKTA MERREN NGA MEDIA

BRILANTA (10), FESTIM (10), ILEA (10), ERION (10), RUMEJSA (11), EURON (10), RINEA (10), RIJAD (10)



## Burimet prej të cilave ne informohemi, quhen media

Ne jemi shumë me fat që kemi një mësuese kaq të mrekullueshme, e cila çdo muaj na pasuron mendjen me romane të ndryshme. Ajo kërkon nga ne që t'i lexojmë këto romane të cilat na pëlqejnë duke filluar nga titulli. Një ndër ta është edhe „Ana Flokëkuqja“, e cila bëri bujë të madhe në tërë botën.

Këtë roman e shkroi shkrimtarja e njohur L. M. Montgomery. Për të arritur këtë famë që ajo e ka, rruga e saj ishte mjaft e gjatë. Për të kanë folur edhe në televizione të ndryshme. Ne kemi hulumtuar nëpër faqe të ndryshme të internetit për biografinë e saj. Hulumtim të cilin e kishim për detyrë ta bëjmë nga mësuesja jonë. Ne i pëlqejmë shumë librat. Prandaj, edhe çdo muaj ne e lexojmë nga një roman, në mënyrë që të fitojmë njohuri nga tregimet e shkruara aty.


Në klasë punojmë individualisht, por edhe bashkëpunojmë me njëri-tjetrin. Kur punojmë në grupe, ne komunikojmë përmes telefonit me shoqet apo shokët e grupit. Në këtë mënyrë, ne i kryejmë detyrat tona. Mjetet që i përmendëm më lart, telefoni dhe romanet ndryshe njihen si media. Media është mjet që neve na ndihmon si për detyrat e shkollës, ashtu edhe për gjërat e tjera që neve na interesojnë.

Kemi dy lloje të medias: media elektronike dhe media e shkruar. Tek media elektronike hyjnë: interneti, kompjuteri, televizioni, radio, telefoni, etj. Ndërsa,

tek media e shkruar hyjnë: librat, gazetat, revistat, romanet, etj. Është një fjali e urtë e thënë nga populli „Njeriu sa të jetojë do të mësojë“, dhe ne pajtohemi plotësisht me këtë thënie. Me burimet e shumta që ofrohen nga media, ne mundemi të vetëarsimohemi dhe kështu jemi çdo herë në hap me kohën.



Sot jemi këtu si gazetarë, të cilët e përfaqësojmë median



Gazeta është njëra ndër burimet e medias së shkruar



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Zenel Hajdini“  
Klasa: V-4  
Vendi: Prishtinë